



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 1480/43 Prot
Shkodër, më 14 . 5 .2021



Nr. _____ Prot
Shkodër, më 14 . 5 .2021

K O N T R A T Ë S H È R B I M I

“Panairi i produkteve agropërpunuese sipas njësive administrative”

Sot, më datë ___/___/2021, në Shkodër lidhet kjo kontratë shërbimi ndërmjet:

BASHKISË SHKODËR me adresë Rr. “13 Dhjetori”, Nr 1, Shkodër, përfaqësuar nga Znj. Voltana ADEMI, në cilësinë e titullarit të Institucionit, në vijim referuar edhe si **“Bashkia”**;

dhe

SHOQATA E ARTIZANËVE DHE ZEJTARËVE TË SHQIPËRISË, me selinë rrugën “Nënë Klelia Merloni” Shkodër, përfaqësuar nga z. Zef Gjini me nr. NIPT-i K77301191H, në cilësinë e kryetarit të shoqatës, në vijim referuare dhe si **“Shoqata”**.

Bashkia dhe Subjekti fitues do të referohen në vijim edhe si “Pala” ose “Palët”.

Duke qënë se Palët:

Vlerësojnë rëndësinë e zhvillimit ekonomik dhe zhvillimit të qedrueshëm të turizmit.

Marrin në konsideratë politikat zhvillimore të Bashkisë Shkodër në drejtim të organizimit të aktiviteteve që synojnë promovimin e elementeve të trashëgimisë kulturore që favorizojnë zhvillimin e turizmit në territorin e saj si dhe promovimin e produkteve vendore.

Synojnë realizimin objektivave zhvillimore të Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.

Njohin eksperiencën e Shoqatës së Artizanëve dhe Zejtarëve të Shqipërisë, e cila e përbërë nga profesionistë artizanë angazhohet në strategjitë dhe nismat për përmirësimin dhe përdorimin e burimeve lokale për zhvillimin e biznesit të vogël dhe të mesëm, për promovimin dhe zhvillimin e artizanatit dhe produkteve të territorit.



Konfirmojnë angazhimin institucional për të bashkëpunuar në vijim të projektit “Panairi i produkteve agropërpunuese sipas njësive administrative”

Neni 1 Baza Ligjore

- 1.1 Kodi Civil ligji nr.7850, datë 29.07.1994, i ndryshuar;
- 1.2 Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; i ndryshuar;
- 1.3 Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar;
- 1.4 VKB nr. 69, datë 30.10.2017 për “Miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër” si dhe miratimin e metodologjisë LOD për financimin e organizatave të shoqërisë civile”;
- 1.5 VKB nr. 63 datë 28.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2021-2023 të Bashkisë Shkodër”;
- 1.6 Urdhër nr.415, datë 06.05.2021 “Për zbatimin e projekteve të shpallura fituese në thirrjen publike për organizatat e shoqërisë civile, sipas udhëzuesit për zbatimin e projekteve në kuadër të metodologjisë LOD, Programi Reload.

Palët së bashku bien dakord të nënshkruajnë këtë Kontratë si më poshtë vijon:

Neni 2 Përkufizime

Termet e përdorura në këtë kontratë, kanë kuptimin e mëposhtëm:

- 2.1 Kontratë**, nënkupton marrëveshjen e shkruar, e lidhur midis Bashkisë dhe Subjektit fitues.
- 2.2 Palë (ët)**, nënkupton Bashkinë dhe Subjektin fitues vec e vec ose të referuar sëbashku në këtë kontratë.
- 2.3 Subjekti fitues**, nënkupton shoqatën e cili do të ofrojë shërbimin sipas përcaktimeve të kësaj kontrate.
- 2.4 Projekt Propozimi**, nënkupton përshkrimin e detajuar të një serie aktiviteteve, që synojnë zgjidhjen e një problemi të caktuar.
- 2.5 Buxheti**, nënkupton shprehjen e projektit në vlera monetare.
- 2.6 Plani i aktivitetit**, nënkupton shtrirjen e aktiviteteve në një periudhë të caktuar kohore.
- 2.7 Tabela indikatorëve**, nënkupton përshkrimin e detajuar të indikatorëve mbi bazën e të cilave bëhet vlerësimi i performancës.
- 2.8 Udhëzuesi për zbatimin e projekteve**, nënkupton udhëzimet për menaxhimin administrative dhe financiar të projektit.
- 2.9 Raport monitorimi**, nënkupton analizimin e informacionit dhe mbikqyrjen e zbatimit të projektit.
- 2.10 Raport përfundimtar**, nënkupton përmbledhjen e dinamikës (veprimtaritë/financat) së zbatimit të projektit nga data e nënshkrimit të kontratës deri në datën e realizimit të aktivitetit.



Neni 3 Qellimi i Kontratës

Kjo kontratë ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve institucionale midis Bashkisë Shkodër dhe Shoqatës së Artizanëve dhe Zejtarëve të Shqipërisë për zbatimin e projektit “Panairi i produkteve agropërpunuese sipas njësive administrative”, e cila ka për qëllim të njihen vlerat kulturore dhe agro-përpunuese të njësive si dhe të arrihet fuqizimi i këtyre artizanë nëpërmjet rritjes së shitjeve si dhe ofrimi në tregun për herë të parë.

Neni 4 Objekti i Kontratës


1. Evidentimi i larmishmerisë kulturore, prodhuese të Njësive Administrative nëpërmjet panairit.
2. Fuqizimi ekonomik i artizanëve.
3. Promovimi i aktiviteteve kulturore në Bashkinë Shkodër.

Neni 5 Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë

- 5.1 Përcakton kriteret e nevojshme dhe specifikimet për zbatimin e projektit, si dhe miraton kalendarin e aktiviteteve.
- 5.2 Harton raportin e monitorimit për shërbimin e kryer nga subjekti fitues në përputhje me specifikimet e përcaktuara në projekt dhe udhësuesit për zbatimin e projekteve.
- 5.3 Bashkia Shkodër ka të drejtën për të mos e kaluar fondin në dispozicion nëse nuk janë përmbushur indikatorët e përcaktuar në kontratë.
- 5.4 Siguron dhe vendos në dispozicion të Subjektit fituesin informacionin e nevojshëm për mbarëvajtjen e zbatimit të projektit.
- 5.5 Siguron kushtet e përshtatshme mjedisore për zhvillimin e aktiviteteve.
- 5.6 Në rastet e forcës madhore, Bashkia mund të kërkojë në çdo kohë rishikimin ose pezullimin e aktiviteteve të projektit.

Neni 6 Të drejtat dhe detyrimet e Subjektit fitues

- 6.1 Zhvillon aktivitetet e përshkruara në planin e aktiviteteve dhe buxhetin bashkangjitur kësaj kontrate me kujdesin dhe cilësinë e duhur.
- 6.2 Siguron zbatimin e projektit sipas Udhësuesit për zbatimin e projektit, në kuadër të Programit ReLOaD.
- 6.3 Harton dhe dorëzon raportet mbi dinamikën (veprimtaritë / financat) e zbatimit të projektit duke shfrytëzuar formatin e raportimit që gjenden në Udhësuesin për Zbatimin e projektit.
- 6.4 Informon Bashkinë për çdo vështirësi të identifikuar gjatë zbatimit të projektit.



- 6.5 Subjekti fitues duhet të mbajë të dhëna të qarta, të sakta dhe të plota në lidhje me shpenzimet e realizuara sipas kësaj Kontrate.
- 6.6 Subjekti fitues do të sigurojë, përpilojë dhe vë në dispozicion në çdo kohë Partnerit Zbatues, Bashkisë Shkodër çdo regjistrim ose informacion, me gojë ose me shkrim, që Bashkia mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve.
- 6.7 Siguron pjesmarrjen e gjerë në aktivitete.
- 6.8 Në rastet e forcës madhore si dhe sipas kërkesës/autorizimit të Bashkisë, subjekti fitues zhvillon aktivitetet sipas kërkesës së bashkisë, në zbatim të vendimeve që dalin për ngjarjet e forcës madhore.

Neni 7 **Afati i Kontratës**

Kontrata i shtrin efektet e saj nga momenti i nënshkrimit, deri në datën 29 Tetor 2021. Ajo mund të zgjatet, nëse është e nevojshme, me dakordësinë e palëve, duke përcaktuar një datë të re përfundimi.

Neni 8 **Vlefëta e Kontratës**

- 8.1 Kontrata lidhet për vlerën 700 000 lekë pa tvsh. Shoqata nuk është subjekt i tvsh-së.
- 8.2 Financimi realizohet nga Buxheti 2021 i Bashkisë Shkodër.
- 8.3 Vlera financiare e kontratës duhet të depozitohet në llogarinë bankare të Subjektit fitues, të cilat detajet janë si më poshtë:

Emri i llogarisë: SHOQATA ARTIZANËVE DHE ZEJTARËVE TË SHQIPËRISË

Emri i bankës: BANKA OTP ALBANIA

IBAN: AL90 2135 1019 0000 0000 0095 7392

- 8.4 Bashkia e Shkodrës do të kryejë likuidimin e vlerës së kontratës, sipas realizimit të planit të aktiviteteve të përcaktuar në projekt, përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së kësaj marrëveshje nga fondi i parashikuar në buxhetin e vitit 2021 të Bashkisë Shkodër.
- 8.5 Levrimi i shumës mund të bëhet në fund të projektit ose gjatë tij. Kusht për levrimin e një shume është realizimi i një aktiviteti dhe dorëzimi i dokumentacionit mbështetës dhe verifikimit të tij nga Bashkia Shkodër për paga, aktivitete, dukshmëri, sipas Udhëzuesit për zbatimin e projekteve për periudhën kohore nga nënshkrimi i kësaj marrëveshje deri në përfundim të saj.
- 8.6 Fondi i miratuar për këtë qëllim është në zbatim të Thirrjes publike për organizatat e shoqërisë civile në Bashkinë Shkodër, Programi Reload.

Neni 9 **Ndalimi i Nënkontraktimit**



Subjekti fitues për zbatimin e projektit për të cilën është shpallur fitues nuk i lejohe të lidhë marrëdhënie nënkontraktuale me një subjekt të tretë.

Neni 10 **Prona Intelektuale**

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Subjekti fitues gjatë kontratës do ti përkasin Bashkisë, i cili mund ti përdorë ato sipas gjykimit të tij.

Neni 11 **Gjuha e Kontratës**

Gjuha e kontratës është gjuha shqipe.

Neni 12 **Vendndodhja**

Aktivitetet duhet të zbatohen ekskluzivisht në territorin e Bashkisë Shkodër, siç janë përcaktuar në projekt.

Neni 13 **Përcaktimi i ngjarjeve të forcës madhore**

Për efekt të zbatimit të kësaj Kontrate forcë madhore do të quhen:

- a. Fatkeqësitë natyrore, që janë përtej kontrollit të arsyeshëm të palës së prekur, të cilat në mënyrë të arsyeshme nuk mund të priteshin që të ndodhnin; kushtet jashtëzakonisht të këqija të motit, rrufetë, tërmetet, ciklonet, përmytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret apo dhe rrëshqitjet e tokës.
- b. Një akt lufte (qoftë i shpallur apo i pashpallur), pushtim, konflikt i armatosur apo akt i armikut të huaj, bllokadë, embargo, trazira, kryengritje, veprime terroriste ose ushtarake, çrregullime civile ose sabotime të motivuara politikisht, që tejkalon një periudhë që zgjat më shumë se 30 (tridhjetë) ditë.

Neni 14 **Zgjidhja e Kontratës në rast të forcës madhore**

13.1 Nëse një ngjarje e forcës madhore vijon apo, sipas gjykimit të arsyeshëm të Palëve, ka të ngjarë të vijojë përtej një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditësh, Palët mund të vendosin ta zgjidhin këtë Kontratë ose ta vijojnë zbatimin e kësaj kontrate, mbi bazën e kushteve të reja të rëna dakord reciprokisht.

13.2 Nëse Palët nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje në lidhje me këtë, Pala e prekur, pas kalimit të periudhës së përmendur prej 30 (tridhjetë) ditësh, do të ketë të drejtën ta zgjidhë këtë kontratë duke lejuar një njoftim zgjidhjeje.



Neni 15
Njoftimet e Palëve

14.1 Çdo komunikim midis palëve do të bëhet me shkrim. Njoftimi i palëve do të bëhet me shkrim brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e faktit dhe problemeve që mund të lindin gjatë ekzekutimit të kontratës.

14.2 Njoftimet duhet të përmbajnë, por nuk kufizohen, tek të dhënat si më poshtë:

- detajet e duhura në lidhje me shkakun e mospërmbushjes dhe të zgjidhjes;
- afatin për korrigjimin e ngjarjes së mospërmbushjes si dhe veprimet/masat, që pasojnë mosrespektimin e afatit, sipas përcaktimeve në këtë kontratë;
- çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

14.3 Adresat dhe numrat e kontaktit, që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj Kontrate, janë:

Për Bashkinë

Voltana Ademi Kryetari i Bashkisë:

Adresa: Rr. "13 Dhjetori", nr. 1, Shkodër,

E – mail: info@bashkiashkoder.gov.al

Për Subjektin fitues:

Zef Gjini, Kryetar i Shoqatës

Adresa: Nënë Klelia Merloni, Shkodër, Shqipëri

Tel: 0672301509 E-mail: artizanati@gmail.com

Neni 16
Mosmarrëveshjet

Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje apo kontraditë do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim. Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit ato i drejtohen zgjidhjes së kontratës duke respektuar procedurat juridike sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 17
Rishikimi i Kontratës

Palët ruajnë të drejtën e rishikimit të Kontratës, në rastet kur Bashkia e vlerëson të nevojshme të kryhen ndryshime thelbësore në këtë Kontratë.

Neni 18
Dispozita të fundit



Adresa: Rr. 13 Dhjetori, nr. 1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

A. PLANI I AKTIVITETEVE

	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3
Rezultati i pritshëm 1: Organizimi i panairit të produkteve agro përpunuese sipas njësive administrative			
Aktiviteti 1: Panairi i produkteve agropërpunuese sipas njësive administrative.			
Shërbimi i gatimit dhe shpërndarja e ushqimit.			
Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikës për zhvillimin e panairit.			
Zhvillimi i aktivitetit artistik.			



B. OSHC OBJEKTIVAT E PERFORMANCËS

Objektivat e performances	Baza	Kohëzgjatja	
		Propozuar	Aktuale
<p>Qëllimi i përgjithshëm i projektit është që nëpërmjet këtij panairi, të njihen vlerat kulturore të Njësisë, të arrihet fuqizimi i këtyre artizanëve nëpërmjet rritjes së shitjeve si dhe ofrimi në tregun për herë të parë.</p> <p>Objektivat specifik:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Evidentimi i larmishmërisë kulturore, prodhuese të Njësisë Administrative nëpërmjet panairit. 2. Fuqizimi ekonomik i artizanëve. 3. Promovimi i aktiviteteve kulturore në Bashkinë Shkodër. 	<p>Sektori i agropërpunimit është një ndër sektorët e ekonomisë e cila gërsheton potencialet e burimeve natyrore, me traditën e rajonit por edhe me interesin në rritje të aktorëve dhe partnerëve të rëndësishëm. Si e tillë vërehet prania e bizneseve agro përpunuese të lidhura drejtpërdrejt me tregtinë. Këto vlera edhe pse të një rëndësie të madhe, nuk po arrijnë të dalin nga lokaliteti i tyre. Një panair me të gjitha njësitë së bashku do i jepte një zhvillim të shtuar këtyre zonave. Do të ndërthuret panairi me muzikë, valle dhe veshje tradicionale të këtyre zonave duke na lejuar të ekspozojmë sa më shumë vlera.</p>	<p>1 Panair i produkteve agro përpunuese sipas njësisë administrative.</p> <p>40 çadra ekspozimi me përmasa 3m X 3m; si dhe 80 tavolina, 80 karrige dhe 80 mbulesa ku do të ekspozohen të gjitha pasuritë e zonës.</p> <p>Ekspozimi dhe ofrimi kulinar me ushqime tradicionale për 100 persona.</p> <p>1 program artistik - muzikë e valle tradicionale të zonave dhe sfilata me veshje kombëtare të tyre.</p> <p>1 spot për TV</p> <p>Transmetim aktiviteti në media</p> <p>Filmimi i plotë i aktivitetit</p> <p>Banner 500 x 80 cm dyanshme</p> <p>Banner 100 x 60 cm</p> <p>Banner 300 x 200 cm</p>	



SHTOJCA 8. BUXHETI I NDARË SIPAS ZËRAVE

Rezultati sipas Kormizës Logjike	Nr	Kategori	Lloji i Njësise	Nr njësi	Kosol për njësi (Lekë)	Total (Lekë)
1.		STAFI				140,000
1.1.		Projekt manaxher - Zef Gjini	muaj	3	30,000	90,000
1.2.		Financier - Paulin Vjerdha	muaj	2	25,000	50,000
2.		SHPENZIME TRANSPORTI				0
2.1						
3		SHPENZIMET E PROJEKTI				
3.1.		Aktiviteti 2: Panairi i produkteve agropërpunuese sipas njësive				510,000
3.1.1		Përgatitja e ushqimeve tradicionale	persona	100	1,000	100,000
3.1.2		Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikës për zhvillimin e panairit				
3.1.2.1		Qera për çadra (tenda) ekspozuese 3x3 m	cope	40	4,500	180,000
3.1.2.2		Qera për tavolina ekspozuese	cope	80	400	32,000
3.1.2.3		Qera për mbulesa	cope	80	250	20,000
3.1.2.4		Qera për karrige	cope	80	350	28,000
3.1.3		Zhvillimi i aktivitetit artistik				
3.1.3.1		Moderator i aktivitetit	shërbim	1	20,000	20,000
3.1.3.2		Trupa e kërcimtareve	persona	10	2,000	20,000
3.1.3.3		Këngëtare	persona	4	5,000	20,000
3.1.3.4		Drejtimes artistik për këngët e vallet	person	1	10,000	10,000
3.1.3.5		Projektor	shërbim	1	25,000	25,000
3.1.3.6		Përgatitje spoti për TV	shërbim	1	10,000	10,000

Muaj 1	Muaj 2	Muaj 3
55,000	30,000	55,000
30,000	30,000	30,000
25,000		25,000
0	0	0
0	0	0
0	0	510,000
0	0	510,000
0	0	100,000
		180,000
		32,000
		20,000
		28,000
		20,000
		20,000
		10,000
		25,000
		10,000



[Handwritten signature]

3.1.3.7	Transmetim aktiviteti ne media	sherbim	1	25,000	25,000
3.1.3.8	Filmimi i plote i aktivitetit	sherbim	1	20,000	20,000
4	DUKSHIMERIA				50,000
4.1	Banner 500 x 80 cm dyanshme	cope	1	25,000	25,000
4.2	Banner 100 x 60 cm	cope	2	5,000	10,000
4.3	Banner 300 x 200 cm	cope	1	15,000	15,000
Totale i kostove Administrative (1+2)					
140,000					
Totale i Kostove të Projektit (3+4)					
560,000					
TOTAL BUXHETI I KERKUAR (Lekë)					
700,000					
BASHKEFINANCIMI (Lekë)					
BUXHETI TOTAL (Lekë)					
700,000					

					25,000
					20,000
	0.00	50,000			0.00
	0.00	25,000			0.00
	0.00	10,000			0.00
		15,000			
20%					
80%					
	55,000	80,000			565,000

Shenime

Për zerrin e buxhetit 3.1.2.1 në koston e qerazë përfshihet dhe transporti, montim/zmontim, mirembajtje dhe ruajtje 24 orë.
Për zerrin e buxhetit 3.1.2.2 dhe 3.1.2.4 në koston e qerazë përfshihet dhe transporti, montimi dhe mirembajtja
Për zerrat e buxhetit 4.1; 4.2 dhe 4.3 në koston e llogaritur është e përfshirë dhe skeleti i drurit për ekspozimin e banerave si dhe montim/çmontim i tyre në lartësi

